



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Kumtesë për Media

RrGK dënon ashpër dhunën ndaj Vitore Stavilecit

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) dënon ashpër dhunën e ushtruar ndaj znj. Vitore Stavileci, duke theksuar se dhuna është e papranueshme dhe e dënueshme edhe me legjislacionin në fuqi. Dhunën nuk e arsyeton asgjë dhe përdorimi i dhunës si shprehje e pakënaqësisë është akt qyqar dhe i ulët.

RrGK thekson se është kundër çdo akti që cenon mirëqenien e gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Kosova duhet të jetë shtet në të cilin dominon liria e shprehjes pa marrë parasysh përkatesitë politike, zgjedhjet e tyre për të ardhmen e tyre dhe fjalët e shprehura.

Andaj RrGK kërkon nga organet e drejtësisë që të reagojnë sa më shpejtë në hetimin dhe zbardhjen e rastit me hetime të pavarura për gjetjen e fajtorëve, duke mos lejuar krijimin e një ambienti kaotik dhe konspirativ i cili mund të përdoret për poena politike nga ndonjë subjekt politik në Kosovë.

Një Kosovë e lirë nga dhuna, me të drejtën e lirë të shprehjes si parim bazik dhe me mundësi zgjedhje të lirë për cdo individ, janë parime me të cilat duhet të ndertojmë shtetin tonë.

Rrjetit i Grave të Kosovës (RrGK) përkrahë, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave anembanë Kosovës, pa marrë parasysh bindjet e tyre politike, religionin, moshën, nivelin e arsimimit, orientimin seksual apo aftësitetë e kufizuara. RrGGK përmbrush misionin e vet përmes këmbimit të përvojave dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimit, hulumtimeve, avokimit dhe ofrimit të shërbimeve. Si Rrjet i mbi 120 organizatave të grave nga të gjitha grupet etnike në tërë Kosovën, RrGGK avokon në emër të grave kosovare në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.